



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF
KOSOVO

Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Data	20.09.19	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	09	Numri	104/02-30911
		Shtojcë	

Në mbështetje të nenit 58, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 6 të ligjit nr. 06/L-073 Për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 e deri në vitin shkollor 1998/99 dhe duke u bazuar në udhëzimin administrativ (MASHT) nr. 17/2019 për Procedurat për njohjen dhe vlerësimin e kontributit për pronarët e shtëpive shkolla dhe objekteve tjera të lëshuara për arsimin shqip nga viti shkollorë 1990/91 e deri në vitin shkollorë 1998/99 Kryetari i Komunës së Kaçanikut më datë 20.09.2019 të merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR IDENTIFIKIM DHE VERIFIKIMIN E SHTËPIVE SHKOLLA DHE OBJEKTEVE TË TJERA TË LËSHUARA PËR ARSIMIN SHQIP NGA VITI SHKOLLOR 1990/91 E DERI NË VITIN SHKOLLOR 1998/99 NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

1. Me këtë vendim, formohet komisioni vlerësues për identifikimin dhe verifikimin e shtëpive shkolla dhe objekteve tjera të lëshuara për arsimin shqip nga viti shkollor 1990/91 e deri në vitin shkollor 1998/99 në Komunën e Kaçanikut, në përbërje prej 3 anëtarëve;
2. Komisioni ka këtë përbërje:
 - 2.1. Ibush Vishi kryetar i komisionit;
 - 2.2. Remzi Çaka anëtar komisioni;
 - 2.3. Sylejman Neziri anëtar komisioni;
3. Detyrat dhe përgjegjësit e komisionit vlerësues janë:
 - 3.1 Identifikimi dhe verifikimi i shtëpive shkolla dhe objekteve tjera të lëshuara për arsimin shqip nga viti shkollor 1990/91 e deri në vitin shkollor 1998/99;
 - 3.2 Përgatitja e raportit të punës nga ana e komisionit.
 - 3.3 Komisioni duhet të përfundoj detyrat dhe përgjegjësit 2 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës.
5. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e Kryetarit të Komunës.
6. Me këtë vendim njoftohen: Arkivi, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës si dhe anëtarët e komisionit.



Kryetari i Komunës